
	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	23.01.2019
Për/ Za/ To:	BESA COLA
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 21.01.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “BESA COLA”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Shërbimet e transportit me marimangë**”RITENDER LLOT II, me Nr. të Prok: 616 18 069 211 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik “BESA COLA”, të dt. 21.01.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e transportit me marimangë”RITENDER LLOT II, me Nr. të Prok: 616 18 069 211, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, të datës 17.01.2019 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.**
2. **Vërtetohet vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 17.01.2019.**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Në kërkesën tuaj keni pohuar se ju keni regjistruar veprimtaritë 4941 dhe 5221 pas publikimit të ankesës.

Ju njoftojmë se asnjë dokument që e ka bazën pas datës së hapjes së tenderit nuk është i pranueshëm. Kjo do të thotë se edhe regjistrimi i veprimtarive në kohën që ju keni cekur nuk mund të pranohet si dokument për vlerësim të këtij aktiviteti.

Ju përkujtojmë se kjo çështje është e rregulluar me nenin 72.3 të LPP-së, në të cilin shkruan, citojmë: "Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive"

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës, departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

